

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

18.02.2025

Ora 12:07

RENDI I DITËS

**“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 09 shkurt –
15 shkurt 2025”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve. Në seancën e sotme publike në rend dite kemi këto çështje:

- Vlerësimin e raportit mbi veprimtaritë publike të institucioneve për periudhën 9 shkurt-15 shkurt 2025.

- Shqyrtimin e raportit të monitoruesit të fushatës zgjedhore po për këtë periudhë.

- Do të vazhdojmë më pas me shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 5 të regjistrit të Partisë Demokratike;

- Shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 9 të regjistrit të denoncimeve, po të Partisë Demokratike;

- Shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 10 të regjistrit të denoncimeve, po të Partisë Demokratike;

- Shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 11 të regjistrit të denoncimeve të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

Mirë atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me raportin e veprimtarive publike për periudhën 9 shkurt deri 15 shkurt 2025. Po Pavlina!

Znj. P. Doçaj: Po faleminderit! Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në ndërfaqen e institucioneve NRI, për periudhën 9 shkurt - 15 shkurt, konstatohen se:

- 12 institucione publike të reja janë regjistruar gjatë kësaj periudhe në NRI dhe kanë akses për raportimin e veprimtarive të tyre;
- 292 raportime janë kryer në total, 283 postime janë aktiye;
- 9 veprimtari janë ndaluar automatikisht nga sistemi për shkak të raportimit jashtë afatit, nga të cilat 4 veprimtari do të duhet të kryhet fillimi i shqyrtimit administrativ dhe 5 veprimtari nuk janë në kushtet e kundërvajtjes administrative.

Katër veprimtari nga tre institucione për fillim shqyrtimi administrativ janë si vijon:

- një veprimtari nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit;
- një veprimtari e KESh.sha.;
- dhe dy veprimtari Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Pesë veprimtari nga 4 institucione nuk janë në kushtet e kundërvajtjes administrative siç edhe e relatuam, sepse brenda afateve ligjore i kanë riraportuar këto veprimtari.

Z. I. Celibashi: Faleminderit. Atëherë, vazhdojmë me pikën e dytë që ka të bëjë me raportin e monitoruesve, po për këtë periudhë.

Znj. L. Veliu: Nga monitoruesit për periudhën 9 - 15 shkurt janë dorëzuar në total 96 raporte monitorimi pranë KQZ. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi që u është bërë këtyre raporteve për këtë periudhë kohore rezulton si më poshtë vijon:

Janë evidentuar 11 aktivitete nga partitë politike, si dhe 33 zyra të hapura për zhvillimin e aktiviteteteve përgatitore të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

Kuvend të datës 11 Maj. Në përfundim nuk janë konstatuar shkelje nga monitoruesit për fushatën zgjedhore.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Vendim nr. 110

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

18.02.2025

Ora 12:11

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ bazuar denoncimin nr. 5 ID, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. I. Osmanaj.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 5 të regjistrit të denoncimeve, bërë nga Partia Demokratike. Po Pavlina!

Znj. P. Doçaj: Denoncimi që mban nr. 5 sipas regjistrit, denoncues është Partia Demokratike. Subjekti i denoncuar është:

- Zonja Ogerta Manastirliu, në cilësinë e Ministrit të Arsimit dhe Sportit;
- Zonja Mirela Kumbaro, në cilësinë e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit;
- Zoti Blendi Çuçi, Zv.kryetar i Kuvendit të Shqipërisë;
- Zoti Taulant Balla, Minister i Shtetit në Marrëdhënie me Parlamentin;
- Zonja Belinda Balluku, Zv.kryeministër dhe Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

Përsa i përket objektit të denoncimit ka të bëjë me konstatimin e shpërdorimit të burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Pala denoncuese pretendon se nga denoncimet dhe raportimet e publikimeve në media të ndryshme, Partia Demokratike ka konstatuar se drejtuesit politikë të Partisë Socialiste të disa qarqeve, emrat të cilët ne sapo i përmendëm, kanë qenë në Athinë dhe Janinë, ku janë hapur zyra informuese për të asistuar të gjithë shqipëtarët që jetojnë jashtë vendit për të marrë pjesë në zgjedhjet e datës 11 maj. Nga ana jonë i është dërguar email gjithë institucioneve dhe kanë kthyer përgjigje me pretendimet përkatëse. Është nisur dhe hetimi administrativ në datën 14.02 kundrejt të gjitha institucioneve. Brenda afateve ligjore, kemi administruar dhe pretendimet e tyre ku duket patjetër që janë të njëjtat pretendime, pasi në tërësi personat përgjegjës për raportimet e të gjitha institucioneve kanë deklaruar se zonja Manastirliu, zonja Balluku, zoti Balla, zoti Çuçi, zonja Kumbaro kanë marrë pjesë në këto takime në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Për këto aktivitete nuk ka asnjë shpenzim që lidhet me fondet publike dhe burimet njerëzore publike. Palët janë njoftuar dhe janë të gjithë prezent.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, lidhur me denoncimin, nëse duan të shtojnë diçka?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po, faleminderit, zoti Celibashi. Ne i qëndrojmë denoncimit të kryer në KQZ te portali i denoncimeve, kryer nga Partia Demokratike lidhur me rastin konkret. Me ministren Belinda Balluku, Ogerta Manastirliu, Mirela Kumbaro, Blendi Çuçi, me ministrin Taulant Balla gjithashtu dhe me eksponentë të tjerë, të cilët mund të jenë cituar në lidhje me takimet elektorale që janë zhvilluar kryesisht jashtë vendit në muajin janar, sidoqoftë pas datës 11 janar. Kemi listuar

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

edhe provat që janë nga burime të hapura, linke të ndryshme, të shoqëruara me fotografitë përkatëse, ku janë të raportuar edhe nga mediat e ndryshme si Reporter. Ai që flasin për keqpërdorim të burimeve shtetërore. Ne i qëndrojmë kërkesës sonë dhe kërkojmë që KQZ të marrë masa administrative për këto veprime, që në vlerësimin e kërkuarit Partia Demokratike, janë të kundraligjshme. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësues të institucioneve të cituara në denoncim, janë prezent. Atëherë me rradhë kush është prezent!

Znj. P. Doçaj: Ministria Arsimit dhe Sportit.

Z. I. Celibashi: Nga Ministria Arsimit dhe Sportit. Fjala për ju! Ju lutem prezantohuni dhe funksioni që keni!

Znj. M. Ramçi, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: Atëherë, unë jam Migena Ramçi, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, jam specialiste pranë drejtorisë juridike të kësaj ministrie. Përsa i përket denoncimit të paraqitur ministria ka sjellë prapësimet edhe në rrugë elektronike. Takimet janë zhvilluar në funksion të saj si deputete dhe jo në kuadër të funksionit si ministër dhe nuk ka përdorim të fondeve publike apo burimeve njerëzore publike.

Znj. Xh. Gjoka, përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit: Përshendetje, Xhulia Gjoka këshilltare, pjesë e kabinetit Kumbaro. Atëherë, zonja Mirela Kumbaro (Furrxhi) në cilësinë e saj si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, më datë 11 dhe 12 ka zhvilluar një takim me diasporën shqiptare në Athinë dhe Janinë. Në këto takime zonja Kumbaro ka diskutuar dhe dëgjuar problematikat e bashkëkombësve

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

tanë në Greqi. Në këto takime nuk ka marrë pjesë në funksionin e saj si ministër dhe nuk ka përdorur asnjë fond publik, asnjë shpenzim që lidhet me fondet publike, apo me detyrën e saj si anëtare e qeverisë. Gjatë bisedave të zhvilluara patjetër qytetarët në diasporë kanë shprehur dhe entuziazmin e tyre dhe dëshirën për t'u regjistruar në procesin e votimit. Siç mund të vihet re dhe nga postimet e zonjës Kumbaro, të cilat janë publike, ajo ka nxitur qytetarët që patjetër të regjistrohen, sepse është një e drejtë e tyre kushtetuese, sipas udhëzimeve të KQZ-së. Për këtë arsye në çdo postim është publikuar dhe është bashkëngjitur edhe linku i KQZ-së. Vlerësojmë se pretendimet, sidomos në lidhje me nenin 77 që lidhet me përkufizimin me ligj të periudhës së fushatës zgjedhore, si dhe kufizimeve të aplikueshme të periudhës 30 ditore, nuk lidhen në asnjë rast me aktivitetin që zonja Kumbaro ka zhvilluar si deputete e parlamentit me qytetarët brenda apo jashtë vendit. Ndërkohë në lidhje me pretendimin tjetër dhe vendimin 193, ky vendim patjetër rregullon veprimtarinë e Komisionit për Informimin e Qytetarëve që jetojnë jashtë vendit. Po, për asnjë moment nuk kufizon që kjo veprimtari mund të kryehet dhe nga deputetët. Për këtë arsye, ne vlerësojmë që ankimuesi ka abuzuar me të drejtën e parashtruar në ankim, pranë KQZ-së. Pak, a shumë këto janë prapësimet tona. Duke ju falenderuar, ne mbetemi në dispozicion për çdo informacion tjetër.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po.

Znj. P. Doçaj: Sipas rradhës është Zv.kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësuesi.

Z. I. Celibashi: Kemi përfaqësues? Po! Mund të flasësh!

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

Z. G. Mebelli, përfaqësues i zv. kryetarit të Kuvendit: Përshëndetje, Glen Mebelli, këshilltar i kabinetit të zv.kryetarit të Kuvendit, si dhe pikë kontakti për raportimin e aktiviteteve me karakter publik, në KQZ-së, sipas nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor. Ne jemi bërë me dije për këtë aktivitet ku ka marrë pjesë zoti Bledar Çuçi, përmes denoncimit nr. 5 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Pas gjithë verifikimeve sqarojmë se: zoti Bledar Çuçi nuk ka marrë pjesë në këtë aktivitet në cilësinë e zv.kryetarit të Kuvendit. Për realizimin e këtij aktiviteti nuk është përdorur asnjë burim i Kuvendit sipas kuptimit që i jep neni 91, i Kodit Zgjedhor. Ndaj kërkojmë rrëzimin e ankesës pasi nuk bën pjesë në aktivitetet sipas lëndës nga subjekti ankues, për konstatim të shpërdorimit të burimeve publike e njerëzore, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Për zotin Çuçi? Jeni të dy të autorizuar për ta përfaqësuar? Po, patjetër. Ju lutem, flisni!

Z. A. Braho, përfaqësues i zv. kryetarit të Kuvendit: Përshëndetje, Alket Braho, këshilltar i zv.kryetarit të Kuvendit. Në vijim të asaj që tha dhe kolegu duhet ta theksoj edhe njëherë që takimet e realizuar në diasporë dhe konkretisht në Athinë, nuk kanë qenë në kapacitetin si zv. kryetar Kuvendi, por si drejtues politik i Partisë Socialiste për Qarkun Vlorë. Veç kësaj, zyrat që në dijeninë time kanë pasur pretendime nga Partia Demokratike, nuk janë zyra të hapura nga zv.kryetari Kuvendit, apo nga Partia Socialiste. Janë zyra të hapura kryesisht nga shoqata tëndryshme të emigrantëve në Greqi, të cilat informojnë dhe asistojnë ata bashkëatdhetarë, të cilët mund të kenë nevojë për asistencë teknike, le të themi, në procesin e regjistrimit. Në vijim të kësaj, mendoj që e gjithë puna informuese dhe thirrjet që bëhen nga përfaqësues politikë të Partisë Socialiste, në këtë rast, edhe nga

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

zv.kryetari i Kuvendit është komplimentare, plotësuese krahas thirrjes apo fushatës së informimit që bën dhe vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Ka përfaqësues?

Znj. O. Berberi, përfaqësuese e Ministrisë së Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin. Odeta Berberi, drejtor kabineti i Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Pasi u njohëm me denoncimin e Partisë Demokratike me nr. 5 ID, prapësimet tona lidhen me faktin që është i pabazuar pretendimi që Ministri i Shtetit ka shkelur nenin 77 të Kodit Zgjedhor. Sa pari, zoti Taulant Balla në takimet e organizuara, më specifikisht takimin e organizuar më datë 18 janar, ka shkuar në cilësinë e drejtuesit politik për diasporën. Në këtë takim, në asnjë moment nuk është prezantuar si Ministër Shteti, por si drejtues politik dhe kjo vërtetohet lehtësisht nga provat dhe faktet e depozituara nga Partia Demokratike në këtë denoncim. Është një njoftim i Ministrit të Shtetit si në rrjetet sociale instagram dhe në facebook ku lehtësisht është evidentuar fakti që takimi bëhet me bashkatdhetarë në cilësinë e tij të drejtuesit politik për diasporën. Në asnjë moment nuk është shkruar cilësimi Ministër Shteti. Së dyti, vizita si drejtues politik për diasporën, ka qenë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe më specifikisht me nenet 91 e vijues, ku në asnjë moment nuk janë përdorur burimet njerëzore dhe absolutisht as materialet e institucionit. Takimi nuk ka pasur një karakter publik në cilësinë e Ministrit të Shtetit, sepse nëse do të kishte një karakter publik në cilësinë e Ministrit të Shtetit, siç kemi raportuar edhe aktivitete të tjera në KQZ, që KQZ-ja i disponon, do të kishim bërë edhe në rastin në fjalë. Edhe përsa i përket përkufizimit të cituar të fushatës zgjedhore, sipas nenit 77 të Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore e fillon vërtet 30 ditë përpara, por as

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

në frymë e as në atë që Kodi Zgjedhor ka parashikuar, nuk i ndalon aktivitetet e subjekteve politike jashtë kësaj periudhe. Ky ka qenë një aktivitet i pastër politik dhe në cilësinë e tij jo vetëm si drejtues politik për diasporën, por edhe të deputetit të Republikës të Shqipërisë. Këtë fakt nuk e ndryshon as fakti që të gjitha subjektet e tjera politike kryejnë të njëjtat aktivitete, deputetë të subjekteve të tjera, përfshirë edhe denoncuesin jashtë territorit të Shqipërisë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësues i...

Znj. P. Doçaj: Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Z. I. Celibashi: Nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësues?

Znj. P. Doçaj: Nuk kanë ardhur.

Z.I.Celibashi: Nuk kanë ardhur!

Znj. P. Doçaj: Pretendime me shkrim kanë sjellë, por nuk kanë ardhur.

Z. I. Celibashi: Dakord. Përfaqësuesia e Partisë Socialiste në lidhje me këtë shqyrtim?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Faleminderit! Atëherë përsa i takon në vijim të shpjegimeve të dhëna nga përfaqësuesit e institucioneve, dua të shtoj se në denoncimin e paraqitur nga Partia Demokratike, qoftë edhe në fjalën e përfaqësuesit të saj sot në këtë seancë, dëgjova shprehje që lidheshin me “takime elektorale,

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

keqpërdorim të burimeve publike apo veprime të kundraligjshme”. Në fakt nga vetë denoncimi, provat e paraqitura dhe bashkëlidhur tij, nuk e di se ku qëndrojnë provat që provojnë pretendimet e ngritura nga Partia Demokratike. Folëm për takime elektorale, kur e dimë që nuk jemi ende në fushatë zgjedhore. Jemi në periudhë zgjedhore, por jo në fushatë zgjedhore referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër, folëm për keqpërdorim të burimeve publike. Nuk kemi asnjë provë se ku qëndron keqpërdorimi i burimeve publike pasi nuk është provuar që është përdorur administrata në këtë rast, nuk është provuar që janë përdorur mjetet e administratës. Nga të gjitha provat e paraqitura provohet krejt e kundërta. Që të gjithë këta përfaqësues të partisë politike dhe dua ta theksoj, përfaqësues të Partisë Socialiste, të një partie politike dhe jo funksionarë administrativë apo politikë, siç janë ministrat në këtë rast. Pra, këta shtetas që sot janë denoncuar nga Partia Demokratike kanë shkuar në shtetin grek, aty bëhet fjalë, në përmbushje të funksionit të tyre politik dhe jo në përmbushje të funksionit të tyre administrativ si ministra. Në këto kushte, akoma më shumë provohet që kanë shkuar në ditë pushimi, ditë e djelë dhe unë nuk e di ku provohet keqpërdorimi i burimeve publike. Folëm për veprime të kundraligjshme. Ku qëndron kundërligjshmëria e veprimeve të këtyre funksionarëve politikë? Ngelet sërish e paprovuar. Do të preferoja shumë që denoncimet që bëhen, të ishin të bazuar në fakte, në prova shkresore, apo qoftë prova filmike, prova fotografike. Në këto raste nuk më rezulton që është një denoncim i bazuar në fakte dhe prova. Nuk përmbushet asnjë element që kërkon Kodi Zgjedhor që të jemi para shkeljeve që sanksionon si të tilla qoftë kalimi i nenit 91, qoftë dhe nga dispozita e sanksioneve. Në këto kushte kërkoj pushimin e çështjes. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po përfaqësues i Partisë Demokratike.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po. Faleminderit! Zoti Celibashi vetëm një një sqarim dhe një kërkesë për informacion shtesë kisha, sidomos përsa i përket takimit në Rimini, në Itali të Ministrit të Shtetit Taulant Balla më 18 janar. Ne, në mos gaboj, kemi depozituar një fotografi që është botuar edhe në media, të një ftese në gjuhën italiane, ku që në fillim thuhet “Po vjen në takim në Rimini, Ministri i Shtetit”. Është bërë publike dhe nga mediat si titull, si material dhe si informacion. Unë e kuptoj që në instagramin personal, apo në instagramin që përdor ministri Balla mund të ketë thënë që është takim në kuadër të funksionit që ai ka gjithashtu dhe si drejtues politik për diasporën në Partinë Socialiste. Por, ne kemi marrë shkas kryesisht nga ai postim, që është botuar dhe në mediat tona, që ftesa në mediat italiane i drejtohej komunitetit në Itali, komunitetit shqiptar në Itali. “Po vjen Ministri i Shtetit Shqiptar”. Për këtë desha sqarime nga përfaqësuesit e Ministrit të Shtetit, se si e vlerësojnë këtë aspekt, në raport me denoncimin e Partisë Demokratike?

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Dëshiron të sqarojë përfaqësuesja?

Znj. O. Berberi, përfaqësuese e Ministrit së Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin: Po! Për sqarim, kur foli dhe përfaqësuesja jonë këtu në KQZ, tha “prova dhe fakte”. Kur flasim për prova e fakte flasim që t’i kërkojmë subjektit prova dhe fakte. Tani provën që subjekti Partia Demokratike thotë për Ministrin e Shtetit është një shoqatë përfaqësuese jashtë territorit të Shqipërisë, që nuk është fare e kondicionuar, e prekur, e detyruar të respektojë parashikimet e Kodit Zgjedhor në Shqipëri. Natyrisht, ata nga momenti që bëjnë lajmërimin dhe mënyrën se si i drejtohen mbështetësve të tyre, apo ata që janë anëtarët e tyre, nuk mund të kondicionohet as nga drejtuesi politik i diasporës, as nga stafi ministrisë, as nga ministri. Ky është një komunikim i brendshëm i tyre me mbështetësit, e cili nuk është

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

kondicionuar as nga Ministri Shtetit, as nga stafi i Ministrisë së Shtetit. Në këtë rast po, do të parashikohej mund të them, një shkelje nga ana e administratës së Ministrisë së Shtetit, keqpërdorim të nenit 91 e në vijim. Por në atë komunikim nuk shoh absolutisht asnjë lloj lidhje me shkeljen e Kodit nga një subjekt që nuk është subjekt i Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Nëse ka prova të tjera përpos atij mesazhi...

Z. I. Celibashi: Po faleminderit! Kemi diskutime të tjera, kontribute të tjera në lidhje me këtë shqyrtim administrativ? Jo nuk kemi, prova dokumente, veç atyre që janë depozituar sot në KQZ. Palët kanë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Jo, nuk kemi prova të tjera përveç këtij komunikimi që sapo e bëmë me dije dhe pati mundësi ta shihte dhe përfaqësuesja e Partisë Socialiste.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë nëse nuk kemi prova të tjera për t'u paraqitur dhe për t'u shqyrtuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e përfundojmë këtu hetimin administrativ të këtij denoncimi. Përfundimisht përfaqësuesi i Partisë Demokratike në cilësinë e denoncuesit kërkon? Pranimin e denoncimit besoj?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po, përfundimisht kërkojmë pranimin e denoncimit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e institucioneve me rradhë.

Znj. M. Ramçi, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit: Migena Ramçi, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, këqoj pushimin e hetimit

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

administrativ në kushtet kur nuk vërtetohet shpërdorim i burimeve publike e njerëzore, në mbështetje të subjektit.

Z. I. Celibashi: Pa arsyetim se arsyetimin e bëtë gjatë pretendimit, vetëm shkurt.

Z. G. Mebelli, përfaqësues i zv kryetarit të Kuvendit: Glen Mebelli, Kuvendi Shqipërisë, kërkojmë rrëzimin e ankesës së subjektit denoncues.

Znj. O. Berberi, përfaqësuese e Ministrisë së Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin: Odeta Berberi, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, kërkojmë që, denoncimi i Partisë Demokratike të konsiderohet i pabazuar dhe për këtë qëllim të pushohet.

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesi i Ministrisë së Turizimit!

Znj. Xh. Gjoka, përfaqësuese e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit: Xhulia Gjoka, këshilltare e kabinetit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, pretendojmë që ankimi është i pabazuar në prova dhe kërkojmë pushimin e çështjes, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i ministrit të Energjitikës dhe Infrastrukturës nuk ishte prezent. Po përfaqësuesi i Partisë Socialiste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Përfundimisht kërkojmë pushimin e denoncimit të Partisë Demokratike. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 18.02.2025*

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, në analizë të çfarë u pretendua nga të gjitha palët dhe të provave të paraqitura nga secila prej palëve, si pala denoncuese, përfaqësues të partive politike, por edhe palët e interesuara në këtë shqyrtim administrativ, vlerësoj se denoncimi i paraqitur nga Partia Demokratike, nuk bazohet në prova. Pra, nuk rezulton që veprimtaritë e karakterit politik të zhvilluara nga ministrat respektivë të denoncuar në këtë denoncim, të kenë qenë në këto aktivitete në cilësitë e tyre shtetërore zyrtare. Ndaj për këtë arsye do të vendosim:

- Pushimin e shqyrtimit administrativ për këtë denoncim. Faleminderit!

Vendim nr. 111

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

**Data 18.02.2025
Ora 12:32**

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 9, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike.

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Znj. I. Osmanaj, znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (F. Nuri) PS (E. Xhina)**
- **OJQ:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit nr. 9 të Partisë Demokratike.

Znj. P. Doçaj: Po, denoncues është Partia Demokratike. Objekti i denoncimit është shpërdorimit i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me drejtuesit politikë të Partisë Socialiste, të cilët, sipas denoncuesit, kanë shkuar në Itali dhe Greqi, për t'u takuar me emigrantët. "Dyshimi ynë dhe i shoqërisë civile konstaton se drejtuesit e partisë politike, Partia Socialiste, gjatë takimeve të tyre janë duke shpërdoruar burime publike në forma të ndryshme për të ndikuar në votën e emigrantëve". Është iniciuar fillimi i procedimit administrativ në datën 14.2.2025 nga ana jonë. Nuk e vërejmë dot në këtë rast subjektet konkrete të denoncimit. Vlerësojmë se, duke qenë se denoncuesi i Partisë

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Demokratike është prezent, do të duhet të bëjë disa shtesa për të evidentuar subjektet konkrete ose individët konkretë që kanë kryer shkelje për të vijuar më tej me hetimin administrativ, sepse është vetëm Partia Socialiste e Shqipërisë pa subjektet konkrete.

Z. I. Celibashi: Mund ta shtyjme nëse keni nevojë për...

Z. F. Nuri: Po, mund ta shtyjme për një moment të dytë dhe do ta shqyrtojmë me denoncimet e tjera që kemi bërë. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

**Data 18.02.2025
Ora 12:34**

RENDI I DITËS

**Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 10, datë 10.02.2025,
të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike.**

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ:** **Znj. P. Docaj**
- **Parti Politike:** **PD (F. Nuri) PS (E. Xhina)**
- **OJQ:** **KRIIK**
- **Të tjerë** **Z. E. Abazi, z. E. Reçi, znj. S. Kapoli**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shqyrtimin e denoncimit nr. 10, të regjistrimit të denoncimeve, të Partisë Demokratike.

Znj. P. Docaj: Është Partia Demokratike edhe në këtë rast. Subjekti i denoncuar është zoti Agron Malaj, në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Mat dhe zonja Bora Muzhaqi në cilësinë e ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Objekti i denoncimit ka të bëjë me promovimin e veprimtarive publike me karakter social, promovimin në rrjetet sociale me profil zyrtar dhe investimit të Bashkisë Mat dhe përdorimi i burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të këtyre subjekteve zgjedhore. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me Bashkinë Mat, ku sipas tyre, ka shpërndarë ushqime dhe ndihma për familjet në nevojë në qytetin e Matit duke

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

nisur në këtë formë një krim zgjedhor, thotë denoncuesi. Gjithashtu, po në të njëjtin denoncim pretendohet se kryetari i Bashkisë Mat në rrjetet e tij sociale *facebook* ka shpërndarë dhe promovuar ngritjen e Qendrës Rinore Mat. Në rrjetin e tij social numërohen dhjetëra postime me sfonde propagandistike, duke promovuar punën e Bashkisë Mat. Po kështu edhe në ditën e promovimit të ngritjes së Qendrës Rinore Mat, kryetari i bashkisë ka qenë i shoqëruar nga ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zonja Bora Muzhaqi.

Ka nisur hetimi administrativ në datën 4.2.2025 nga ana jonë. Palët kanë paraqitur pretendimet nëpërmjet imeilit ku Bashkia Mat pretendon se nuk ka kryer apo ka promovuar veprimtari të ndaluara në kuptim të dispozitave ligjore dhe nënligjore, pasi ndihmat ushqimore nuk janë në dispozicion të vendosura nga fondet e buxhetit të Bashkisë Mat, por janë të vendosura në dispozicion dhe të dhuruara nga një subjekt, një shoqatë dhe shpërndarja e tyre është bërë nga vetë shoqata. Ndërsa në lidhje me pretendimin se ka kryer dhe ka promovuar veprimtari të ndaluara në kuptim të dispozitave ligjore apo ato nënligjore, Bashkia Mat thekson se nuk ka shkelur dispozitat ligjore dhe për këtë motiv e quan të pabazuar pretendimin e palës denoncuese. Ministrja e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka sjellë pretendimet nëpërmjet imeilit dhe thekson se Qendra Rinore në Bashkinë Mat është realizuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore për financimin e projekteve, që kanë të bëjnë me njësitë e qeverisjes vendore dhe rregullave, dhe nuk ka shkelur nenin 91 e vijues të Kodit Zgjedhor. Palët janë prezentë të dyja. Kryetari i Bashkisë Mat është prezent dhe përfaqësuesi i ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ju lutem, prezantohuni gjatë relatimit të pretendimit të gjithsecilit prej jush.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Z. E. Abazi: Përfaqësuesi Eduart Abazi i Bashkisë Mat, me autorizim, drejtor i Çështjeve Ligjore në Bashkinë Mat. Siç kemi parashtruar edhe në kundërshtimet në lidhje me konstatimet në denoncimin e subjektit politik Partia Demokratike për shpërndarjen e ndihmave ushqimore nga Bashkia Mat, ndryshe nga sa kanë parashtruar në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, rezulton se Bashkia Mat nuk ka kryer asnjë aktivitet me fondet e saj publike, ku konkretisht në lidhje me veprimtarinë e datës 31.1.2025 për shpërndarjen e ndihmave ushqimore familjeve në nevojë dhe jetimëve, që i referohet subjekti politik Partia Demokratike, vërtetohet fakti se kjo veprimtari nuk është zhvilluar nga ana e Bashkisë Mat dhe për më tepër me fondet e saj, pasi dhuruesi, subjekti, shoqata “Qatar Charity”, i cili vazhdimisht ofron dhe shpërndan ndihma dimërore për familjet në nevojë, në datën 29.1.2025 ka nënshkruar kontratën e dhurimit me nr. Prot A1/2025/01 me përfituesin Bashkia Mat, për dhurimin e 250 pakove me ndihma ushqimore për familjet me vështirësi social-ekonomike, ku shpërndarja e pakove është kryer nga vetë kjo shoqatë dhe Bashkia Mat, në bazë të kushteve të kontratës, ka vënë në dispozicion të dhuruesit vetëm listën e familjeve në nevojë dhe ka kryer monitorimin e procesit të shpërndarjes së tyre. Për sa më lart, ndryshe nga sa parashtron në mënyrë të gabuar subjekti politik Partia Demokratike, vërtetohet se Bashkia Mat nuk ka kryer apo promovuar veprimtari të ndaluar në kuptim të dispozitave ligjore e nënligjore të sipërcituara, pasi ndihmat ushqimore nuk janë vënë në dispozicion me fondet e Bashkisë Mat apo miratuar rishtazi në buxhet, por janë dhuruar nga subjekti shoqata “Qatar Charity”, ku dhe shpërndarja e tyre është kryer nga vetë shoqata, kjo deklaruar në rrjetet sociale dhe nga vetë përgjegjësja e Departamentit të Ndhmës Sociale të shoqatës “Qatar Charity Albania”, zonja Enkeleda Balliu. Bashkëlidhur kemi paraqitur kontratën e dhurimit dhe kopja e statusit e publikuar nga zyrtari i shoqatës së sipërcituar. Gjithashtu, në lidhje me

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

promovimin në rrjetet sociale të denoncimit tjetër të punëve të kryera nga Bashkia Mat, si dhe në lidhje me veprimtaritë e promovimit të investimeve të kryera dhe që po kryhen në territorin e Bashkisë Mat, rezultojnë se këto veprimtari nuk bëjnë pjesë në ato veprimtari që janë të ndaluara për t'u promovuar në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, "Veprimtari të ndaluara", të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i ndryshuar me vendimin nr.16, datë 21.12.2024, ku kemi fituar dispozitën, konkretisht në rastet që parashtron subjekti politik Partia Demokratike rezulton se në lidhje me promovimin për ngritjen e Qendrës Rinore Mat ky investim është kryer në vitin 2024, ku në zbatim të kontratës së sipërmarrjes me nr. Prot. 2613/12, datë 16.8.2024, punimet kanë filluar në muajin shtator 2024 dhe kanë përfunduar në muajin dhjetor 2024 për periudhën katërmujore. Pra vërtetohet që nuk është investim i kryer me buxhet të miratuar në periudhën katërmujore para datës së zgjedhjeve. Gjithashtu, edhe në lidhje me zhvillimin e veprimtarisë së promovimit të datës 28.1.2025, ora 10.00, të kësaj qendre rinore multifunktionale, ku ka marr pjesë kryetari i Bashkisë Mat, ministrja e shtetit për Rinën dhe Fëmijët e të tjerë, Bashkia Mat ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve NRI për zhvillimin e këtij aktiviteti në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Rast i shqyrtuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 59, datë 31.1.2025. Po ashtu edhe në lidhje me publikimin nga subjekti kryetari i Bashkisë Mat në rrjetin e tij social *facebook* të investimeve të tjera që përmenden nga ana e subjektit politik, si ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve i impiantit të ujërave të ndotura është një investim që po kryhet nga shoqëria e ujësjellës-kanalizimeve Dibër, i cili ka filluar që në vitin 2022, pra vërtetohet që edhe ky investim nuk është investim i kryer me buxhet të miratuar në periudhën katërmujore para datës së zgjedhjeve. Ndërsa publikimet e tjera në rrjetet sociale janë publikime të investimeve, punimeve, të cilat kanë filluar që në vitin 2024 dhe punë të kryera në infrastrukturë në kuadër

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

të veprimtarisë që ushtron Bashkia Mat nëpërmjet Agjencisë së Funksioneve të Transferuara, agjenci kjo nën varësinë e Bashkisë Mat, ku në rastin kur ka pasur inspektime nga vetë kryetari i bashkisë, ato janë raportuar si veprimtari në ndërfaqen e raportimeve NRI, faqja zyrtare e KQZ-së. Bashkëlidhur kundërshtimeve kemi paraqitur kopje të raportimit në NRI.

Për sa më lart, ndryshe nga sa parashtron në mënyrë të gabuar subjekti politik Partia Demokratike, vërtetohet se Bashkia Mat nuk ka kryer apo promovuar veprimtari të ndaluara në kuptim të dispozitave ligjore dh nënligjore të sipërcituara, pasi në rrjetin social të subjektit Agron Malaj, kryetar i Bashkisë Mat, janë kryer publikime për investimet e filluara në vitin 2024 dhe më herët, si dhe janë publikuar punët e përditshme që kryhen me punonjësit e Agjencisë të Funksioneve të Transferuara, agjenci kjo nën varësinë e Bashkisë Mat.

Gjithashtu, edhe në lidhje me pretendimin për dhurimin e aseteve publike dhe burimeve njerëzore, subjekti politik Partia Demokratike i referohet ditës së inaugurimit të Qendrës Rinore Multifunksionale Rekreative Inovacion dhe Art, ku si aset publik i lidhur drejtpërdrejt me Bashkinë Mat konsideron Qendrën Rinore Mat, ndërsa burim njerëzor i institucionit cilëson ministren Muzhaqi. Pretendimi i subjektit politik është i gabuar, pasi, përveç faktit që në këtë ditë është zhvilluar inaugurimi i kësaj qendre, ku zhvillimi i veprimtarisë dhe pjesëmarrësit kanë qenë të raportuar në ndërfaqen e raportimeve NRI, zhvillimi i këtij aktiviteti është në zbatim të përcaktimeve të Kodit Zgjedhor parashtruar më lart. Fakt tjetër është se nuk gjendemi edhe përpara kushteve që parashikon dispozita e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pasi nuk kemi vënie në dispozicion të burimeve publike qoftë asete apo njerëzore në fushatë zgjedhore, pasi në atë ditë nuk kemi kryerje të ndonjë fushate apo tubimi elektorale si për ndonjë kandidat, ashtu edhe për parti politike, raste këto të fundit që i ndalon dispozita e nenit 91 të Kodit Zgjedhor. Por kemi një ditë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

inaugurimi të një qendre rinore multifunksionale, e cila është bashkëfinancuar nga fondet e ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Bashkisë Mat.

Për sa më lart, ndryshe nga sa parashtron në mënyrë të gabuar subjekti politik Partia Demokratike, vërtetohet se Bashkia Mat nuk ka përdorur dhe vënë në dispozicion burime publike, asete apo njerëzore, pasi atë ditë ka qenë inaugurimi i qendrës rinore multifunksionale, e cila është bashkëfinancuar nga fondet e ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Bashkisë Mat në vitin 2024 dhe nuk jemi përpara rastit që trajton dispozita e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, atë të vënies në dispozicion të burimeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive në fushata apo tubime elektorale.

Përfundimisht, për sa parashtruar më lart, vërtetohet se Bashkia Mat nuk ka kryer veprimtari të ndaluara për t'u promovuar dhe se pretendimet e subjektit politik Partia Demokratike janë të pabazuara në ligj, fakte e prova. I kërkojmë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pas shqyrtimit administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Mat, të vendosë pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Mat. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesja e ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Znj. S. Kapoli: Përshëndetje! Jam Sara Kapoli, përfaqësuese me pozicion këshilltare e ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Lidhur me fillimin e hetimit administrativ për denoncimin e regjistruar nga subjekti zgjedhor, kemi marrë dijeni përmes postës elektronike në datën 12 shkurt. Gjithashtu, të gjitha pretendimet dhe qëndrimet tona e kemi paraqitur nëpërmjet mjeteve elektronike në mënyrë të shkurtër, ku themi që ministrja e Shtetit për Rininë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

dhe Fëmijët nëpërmjet institucionit të tij të varësisë, Agjencisë Kombëtare të Rinisë, në zbatim të të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, ka financuar projektet e propozuara, ku ndër të tjerat edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në kuadër të thirrjes publike të shpallur nga kjo Agjenci gjatë vitit 2024, projekti i Bashkisë Mat është shpallur fitues dhe është financuar përmes fondeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2024. Pra, mund të themi që ngritja dhe inaugurimi i qendrës rinore në Bashkinë Mat është realizuar në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore për financimin e projekteve. Qëllimi i vetëm i inaugurimit të kësaj qendre është për t'i shërbyer nxitjes dhe mbështetjes së të rinjve në procesin e punësimit, për zhvillimin e trajnimeve, punëtorive, programeve, praktikave profesionale etj. Gjithashtu, ky aktivitet është raportuar duke marrë në konsideratë të gjitha afatet edhe në ndërfaqen NRI të KQZ-së. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Ka pasur aty përfaqësues të partive politike, të Partisë Socialiste, si parti në pushtet? Keni bërë, apo jo ftesa? Apo keni bërë ftesa dhe nuk ju kanë ardhur, apo nuk keni bërë ftesa për përfaqësues?

Z. E. Reçi: Elson Reçi, Bashkia Mat, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm dhe koordinator me KQZ-në. Si personi që deklaroj në sistem aktivitete, nuk ka pasur ftesa dhe nuk ka pasur persona, të cilët nuk kanë pasur një detyrë funksionale në aktivitetin e realizuar në inaugurimin e qendrës rinore.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Veçmas çfarë keni paraqitur me shkrim dhe atyre çfarë prezantuat sot, keni dokumente të tjera për të paraqitur në këtë shqyrtim? Jo.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Z. E. Reçi: Jo.

Z. I. Celibashi: Jo. Përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Z. F. Nuri: Faleminderit, zoti Komisioner! Ne jemi dakord dhe i qëndrojmë plotësisht kërkesës si Parti Demokratike për denoncimin në fjalë, pavarësisht shpjegimeve që dhanë përfaqësuesit e subjekteve të thirrura në këtë dëgjese. Po e bëjmë në formë pyetje ndoshta, për qendrën rinore të fëmijëve. Sipas legjislacionit në fuqi për arsimin, këto qendra janë apo nuk janë në varësi të njësisë administrative, pra, në rastin konkret a janë në varësi të Bashkisë Mat?

Z. E. Abazi: Qendrat rinore janë qendra komunitare në varësi të bashkive, jo të Ministrisë së Arsimit, nuk kanë lidhje as me shkollat, as me pjesën e organizimit nga ato. Ne jemi personat që e administrojmë qendrën dhe ne jemi personat që zhvillojmë aktivitetet, pasi ligji i vitit 2020 është ngritja e këshillave vendorë rinorë dhe të gjitha këta këshilla, që miratohen me vendim të këshillit bashkiak me një mandat të përcaktuar 2-vjeçar, kryejnë aktivitete në një ambient të përcaktuar. Bashkia Mat deri në ngritjen e kësaj qendre nuk e ka pasur një gjë të tillë dhe kjo qendër është në fokus të të gjithë veprimtarisë që kryen këshilli rinor vendor i Bashkisë Mat dhe jo në pjesë të strukturave të arsimit apo të shkollave.

Z. F. Nuri: Faleminderit për këtë pohim! Faktikisht, bazuar në nenin 15 të ligjit për arsimin, qendrat kulturore të fëmijëve janë institucione plotësuese në varësi të njësisë së qeverisjes vendore.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Z. E. Abazi: Nuk është qendër kulturore e fëmijëve. Është qendër rinore. Qendra kulturore e fëmijëve është në varësi të dyfishtë: arsim-bashki. Është qendër tjetër, mos i ngatërroini. Po flet për diçka tjetër që nuk ka lidhje me qendrën për të cilën po flasim ne.

Z. F. Nuri: Gjithsesi, edhe ju e pranuat që edhe qendra në fjalë është në varësi të bashkisë, apo jo.

Z. E. Abazi: Qendra rinore është 100% në varësi të bashkisë dhe nuk ka lidhje me arsimin apo me aktivitetet e përcaktuara në ligjin për arsimin.

Z. I. Celibashi: Ne po flasim për këtë qendër, apo jo?

Z. E. Abazi: Ndërsa citimi që po bën është për qendrën kulturore.

Z. F. Nuri: Iu referova legjislacionit.

Z. E. Abazi: Të lutem, është ligj tjetër, është qendër tjetër. Nuk ka lidhje me qendrën rinore.

Z. F. Nuri: Fakt është që u pohua që është qendër në varësi të bashkisë, ndaj ne e kemi sjellë si denoncim, sepse është një institucion në varësi të Bashkisë Mat, është bërë ky investim, është thirrur edhe ministrja kompetente për atë rast për të bërë inaugurimin pas datës 11 janar. Kështu që ne e konsiderojmë shkelje dhe i qëndrojmë kësaj.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Në lidhje me shpërndarjen e ndihmave humanitare nga shoqata që pretendohet sipas përfaqësuesve, një pyetje, unë nuk e njoh Bashkinë Mat me detaje: sipas këtij denoncimi të bërë edhe nga mediat, me këtë fotografi, mund të na e identifikoni ambientin përkatës, besoj ju e njihni më mirë, çfarë institucioni është ky, apo çfarë godine është?

Z. E. Abazi: Është pallati i sportit.

Z. F. Nuri: Pallati i sportit. Është në varësi, apo jo të bashkisë?

Z. E. Abazi: Po, patjetër.

Z. F. Nuri: Këtu, sipas fotografive që kanë dalë në ato media, ka disa persona që janë duke marrë këto ndihma, sipas pretendimit të burimeve mediatike në derën apo në oborrin e këtij institucioni. Prandaj ne e kemi sjellë këtë denoncimin në lidhje me këtë. Patjetër, bazuar në burime të hapura, por që është kryer në ambiente të tilla, që janë në varësi të bashkisë. Ka konfondim me ndihmën humanitare dhe me ambientet ku shpërndahen këto ndihma. Këtu është një denoncim tjetër nga mediat. Këtë ambientin mund ta identifikoni, është i njëjtë me atë më përpara, ku është ky zotëria me qese në duar? E njëjta është. Pra, është te dera e qendrës kulturore.

Z. E. Abazi: Pallati i sportit.

Z. F. Nuri: Dakord, të Bashkisë Mat, prandaj edhe ne e sollëm si denoncim, sepse patjetër që e pamë edhe nga mediet të botuar si rast. Nga ana tjetër, vetë shoqata, ne nuk shohim që ta ketë denoncuar si rast ose të jetë distancuar për të thënë që kjo nuk

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

ka lidhje me bashkinë, por jemi ne që e kemi bërë. Kemi bërë një investigim të thjeshtë në rrjetet sociale të shoqatës “Qatar Charity Albania” dhe nuk ka asnjë postim në lidhje me këtë, përgënjeshttrimin e ka bërë bashkia. I kemi depozituar si prova *screenshot*-et përkatëse.

Nga ana tjetër, zoti Komisioner, edhe diçka që mund të duket e vogël, por ne mendojmë që përbën shkelje. Zoti Malaj, kryetari i Bashkisë Mat, në postimet që ka bërë, ne i kemi sjellë si prova, përdor hashtagët, që anë konotacion politik “Shqipëria 2030”, “Vetëm përpara”, “Krenar për Shqipërinë”. Kemi një, por kemi sjellë disa raste këtu, që ne mendojmë se përbëjnë shkelje në lidhje me këto. E kemi sjellë si provë. Kemi edhe prova të tjera bashkëlidhur, ku përsëri ka përdorim të hashtagëve përkatëse që e lidhin publikimin përkatës me konotacion politik. Këto sqarime kishim për rastin konkret. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i bashkisë.

Z. E. Abazi: Në lidhje me reagimin që ka bërë organizata, ne e kemi depozituar edhe si provë dhe përsëri e kemi si material, ku ne na distancojmë totalisht nga pjesa e veprimtarisë, pasi edhe në kontratat e depozituara e ka të shënuar, sepse kjo është një punë, e cila bëhet nga organizata për vite të tëra në Mat dhe në shumë bashki të tjera. Kjo nuk është e bërë rishtazi, apo e bërë në fokus të aktiviteteve që citohen nga Partia Demokratike. Ambienti i pallatit të sportit është vendosur si ambient publik, i cili mund të përdoret sikurse jepet për ambientet e tjera kundrejt një tarife apo pa tarifë sipas vendimit të këshillit bashkiak për t’u përdorur dhe për të ushtruar aktivitetin një organizatë, e cila me Bashkinë Mat ka një kontratë dhurimi për familjet që i ka të përcaktuara ato, kategoritë dhe target grupet e tyre. Nuk ka asnjë

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Iloj shkelje, pavarësisht publikimit në medie, por për ne është komplet e padrejtë dhe kërkojmë të rrëzohet.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesja e ministrit të Shtetit për këtë? Nuk ka gjë për të shtuar.

Z. E. Reçi: Doja të shtoja diçka në lidhje me disa postime të kryetarit të bashkisë. Ne nuk i kemi në objektin e denoncimit për të cilin i jemi referuar këtij hetimi administrativ.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi pretendime të tjera shtesë?

Z. F. Nuri: Nuk kemi të tjera dhe i qëndrojmë përfundimisht kërkesës sonë.

Z. I. Celibashi: Prova të tjera veçmas atyre që janë paraqitur deri më sot nga palët? Nuk kemi. Përfundojmë hetimin administrativ. Fjala e fundit për përfaqësuesin e Partisë Demokratike dhe pastaj për secilin prej përfaqësuesve të palëve të treta. Përfundimisht.

Z. F. Nuri: Përfundimisht ne i qëndrojmë kërkesës së depozituar. Faleminderit!

Z. E. Abazi: Bashkia Mat përfundimisht kërkon pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Mat si të pabazuar në ligj e prova denoncimi i subjektit Partia Demokratike.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesja e ministres së Shtetit.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Znj. S. Kapoli: kërkojmë pushimin e hetimit administrativ për ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Vendimin për këtë denoncim do ta shpallim pas disa ditësh. Do t'ju njoftohet dhe komunikohet nëpërmjet mjeteve të komunikimit që kemi së bashku.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

**Data 18.02.2025
Ora 12:54**

RENDI I DITËS

Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin me nr. 11, datë 11.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.

PJESËMARRJA:

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PD (F. Nuri) PS (E. Xhina)**
- **OJQ:** **KRIIK**
- **Të tjerë:**
 - Ministria e Arsimit (M. Ranxhi)**
 - Ministria e Financave (E. Bedalli)**
 - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (A. Dyrmishi)**
 - Ministria e Brendshme (A. Biti)**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me denoncimin e organizatës KRIIK.

Z. P. Doçaj: Denoncimi me nr. 11 të regjistrit, denoncues organizata KRIIK, subjekti i denoncuar zonja Ogerta Manstirliu, ministre e Arsimit dhe Sportit, zoti Petrit Malaj, në funksionin e ministrit të Financave, zoti Blendi Gonxhaj, zonja

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Belinda Balluku, zoti Ervin Hoxha. Objekti i denoncimit ka të bëjë me përdorimin e sloganeve dhe hashtagëve në postimet e aktiviteteve institucionale të ministrive. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me periudhën parazgjedhore. Në faqen zyrtare të *facebook*-ut të ministrive në vend janë duke u përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste në formën e hashtagëve. Këto slogane janë vërejtur në faqet zyrtare të *facebook*-ut të ministrive si më poshtë: Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Brendshme. Nëpërmjet vendimit nr.85, datë 12.2.2025 KSHZ-ja ka nisur hetimin administrativ. Janë paraqitur edhe pretendimet e palëve të denoncuara. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pretendon se janë transmetuar *live* aktivitetet të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të realizuara nëpërmjet një regjie televizive, e cila ka akses në këtë faqe për të bërë të mundur pasqyrimin e këtyre aktiviteteve. Gjatë transmetimit ka pasur një gabim teknik dhe regjia ka përdorur në mënyrë të gabuar hashtagët e vjetër, të cilët, ashtu siç mund të konsiderohen edhe lehtë nga një vëzhgim i faqes së *facebook*-ut, nuk janë të përdorur prej kohësh. Lidhur me këtë gabim, është bërë edhe fshirja e hashtagëve të gabuar nga postimet e denoncuara. Ministria e Financave pretendon që gjatë publikimeve të saj në asnjë rast në ministri nuk ka publikuar përmbajtje apo postime që kanë të reflektuara slogane apo hashtagë me përmbajtje politike, sikurse është ngritur edhe pretendimi nga organizata KRIIK. Ka të bëjë me dy postime të datës 15 janar dhe 6 shkurt dhe nuk ka të bëjë me postime të mirëfillta, por me shpërndarje dhe në to nuk është reflektuar asnjë shtesë apo përsëritje të postimeve kryesore të figurës publike politike, gjë e cila konfirmon faktin që nuk kemi të bëjmë me një përdorim të përmbajtjeve politike. Ministria e Brendshme pretendon se në faqen e Ministrisë së Brendshme janë përdorur këto postime pa bërë asnjë koment shtesë si në postimin e datës 31 janar, ashtu edhe në

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

atë të datës 5 shkurt dhe është e qartë që në tekstin e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme nuk ka asnjë hashtag me përmbajtje politike. Ministria e Arsimit dhe Sportit pretendon që në kushtet kur nuk ka ende të regjistruar kandidatë të partive politike ose koalicione në zgjedhje, konsiderojmë se pretendimi i publikimit të hashtagëve të partive elektorale nuk qëndron, mund ta bëjë ligjërisht dhe nuk është denoncim që duhet të merret në konsideratë. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit pretendon se gjatë zhvillimit të veprimtarive politike objekti i denoncimit nuk janë përdorur shenja, logo, slogane, pankarta, materiale propagandistike që identifikojnë subjekt zgjedhor apo kandidatë në zgjedhje. Janë njoftuar palët e denoncuara dhe janë prezente. Fillimisht Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Z. I. Celibashi: Po.

Znj. M. Ranxhi: Përshëndetje! Migena Ranxhi, përfaqësuese e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Për sa i përket rastit të referuar, ministria ka mbajtur qëndrimin që përdorimi i hashtagëve në faqen zyrtare nuk mund të konsiderohet si burim ose aset publik në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, por, pavarësisht kësaj, gjatë ditëve në vijim janë marrë masa që të fshihen nga faqja e Ministrisë së Arsimit ripostimet që kanë pasur si hashtag përmbajtjen e referuar.

Z. I. Celibashi: Po. Vazhdojmë me radhë. Zonja tjetër.

Znj. P. Doçaj: Ministria e Financave.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Znj. E. Bedalli: Përshëndetje! Elona Bedalli, këshilltare pranë ministrit të Financave. Ne kemi paraqitur pretendimet me shkrim në lidhje me dy rastet e denoncuara. Mendojmë që, nëse bëhet një verifikim te faqet në *facebook* dhe në rrjetet sociale qoftë të ministrisë së Financave, ashtu edhe të ministrit, do të shikoni që nuk ka përdorim në asnjë rast të hashtagëve të pretenduar. Ka vetëm dy raste. Një rast është një shpërndarje e një titullari dhe rasti tjetër i ministrit të Financave, i cili pas denoncimit është reflektuar dhe janë fshirë hashtagët nga faqja, por ne ngremë gjithashtu pretendimin që këta janë hashtagë, të cilët nuk kanë asnjë qasje politike dhe nuk janë të vlefshëm në momentin kur do të hyjmë në procesin zgjedhor. Prandaj ne i konsiderojmë të pavlefshme pretendimet e ngritura nga denoncuesi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Znj. P. Doçaj: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Znj. A. Dyrmishi: Përshëndetje! I nderuar Komisioner, në zbatim të autorizimit 2792 Prot, datë 18.2.2025, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit do të prezantohet nga unë Arsjola Dyrmishi, me funksionin drejtore e Drejtorisë së Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Ne u qëndrojmë prapësimeve të depozituara edhe me shkrim në datën 14.2.2025 në zbatim të afatit të vendosur nga KQZ-ja, bazuar në komunikimin elektronik të datës 12 shkurt 2025. Për efekt të kohës dhe për të mos përsëritur parashtrimet dhe prapësimet tona të depozituara me shkrim, pavarësisht faktit që ne ndajmë bindjen që në të gjitha aktivitetet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nuk janë përdorur slogane, logo apo materiale të tjera, të cilat bien në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor lidhur me periudhën parazgjedhore dhe pavarësisht se janë ndjekur të gjitha

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

procedurat për njoftimin e këtyre aktiviteteve, në vlerësim të denoncimit të ngritur nga KRIIK, por edhe duke vlerësuar çdo ankesë të paraqitur nga aktorë të ndryshëm në funksion të zbatimit të ligjshmërisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka ndërmarrë masat duke fshirë të 6 postimet, të cilat janë objekt i ankesës së KRIIK.

Znj. P. Doçaj: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Z. I. Celibashi: Nuk kemi përfaqësues.

Znj. P. Doçaj: Ministria e Brendshme.

Z. A. Biti: Përshëndetje! Jam Ardian Biti, drejtor, koordinator për të drejtën e informimit në Ministrinë e Brendshme. Ne, zoti Komisioner, pretendimet tona i kemi dërguar edhe me shkrim, por gjithsesi ajo që doja të shtoja është se praktikisht dhe teknikisht shpërndarja e një postimi nga një burim në një tjetër, mendoj që nuk mund të cilësohet një promovim i një aktiviteti apo mesazhi politik. Në fakt, kjo është një praktikë e zakonshme e institucioneve, e cila përdoret për të shpërndarë informacion publik në shërbim të qytetarëve. Pretendimet e tjera i kemi dërguar edhe me shkrim, presim vendimmarrjen tuaj. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Veçmas sa keni paraqitur dokumente, pretendime dhe ato që prezantuat sot, shtesë nuk keni? Nuk keni. Atëherë, përfundimisht në lidhje me denoncimin, përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.18.02.2025*

Z. M. Ranxhi: Kërkoj pushimin e hetimit administrativ ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Znj. A. Dyrmishi: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit kërkon pushimin e hetimit administrativ.

Znj. E. Bedalli: Ministria e Financave kërkon rrëzimin e pretendimit të denoncuesit.

Z. A. Bida: Ministria e Brendshme kërkon pushimin e hetimit administrativ.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ne përfundojmë shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe vendimin do t'ju komunikojmë nëpërmjet imelit në ditët në vijim. Faleminderit! Çështje të tjera nuk kemi. Seanca mbyllet. Ditë të mbarë!

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*

